



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 9, datë 31.01.2022

**PËR
MIRATIMIN E PËRSHTATSHMËRISË SË SHOQËRISË “RAIFFEISEN INVEST”
SH.A., DHE TË FONDEVE TË INVESTIMIT ME PJESËMARRJE TË HAPUR ME
OFERTË PUBLIKE “RAIFFEISEN PRESTIGJ”, “RAIFFEISEN INVEST EURO” DHE
“RAIFFEISEN VIZION”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe Rregullores nr. 112, datë 31.08.2020 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

- 1. Miratimin e përshtatshmërisë së shoqërisë “Raiffeisen Invest” sh.a., shoqëri administruese e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, me kërkesat e Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” dhe rregulloreve në zbatim të tij.**
- 2. Miratimin e përshtatshmërisë së fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike “Raiffeisen Prestigj”, “Raiffeisen Invest Euro” dhe “Raiffeisen Vizion” me kërkesat e Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” dhe rregulloreve në zbatim të tij.**
- 3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**